



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja a, dhe të nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Muhamed (Beqir) Bajgora, Nuhi (Ilaz) Bajgora, Kastriot (Salih) Bajgora, Vigan (Driton) Bajgora dhe Shqipe (Sherif) Konjuhi.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 1949-10, certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01949-10, Zona Kadastrale (ZK) Prishtinë, pasuri shoqërore, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 1796-1, certifikata e pronësisë nr. P-71914059-01796-1, ZK Prishtinë, e destinuar për “rrugë”, të planifikuar sipas e Planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë në pronësi të Muhamed (Beqir) Bajgorës, Nuhi (Nuhi) Bajgorës, Kastriot (Salih) Bajgorës, Vigan (Driton) Bajgorës dhe Shqipe (Sherif) Konjuhit.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” dhe PZHU-së. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të këmbet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmben, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastral të Komunës.



- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë e këtij vendimi janë shkresat e lëndës.
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0263703/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

